

**URDHËR**  
**Nr.168/1, datë 15.3.2020**

**PËR KUFIZIMIN E LËVIZJEVE BRENDIA VENDIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërmat “d” të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

**URDHËROJ:**

1. Ndalimin e lëvizjeve me mjetet e transportit publik dhe privat të udhëtarëve qytetas, ndër-qytetas dhe rreth-qytetas deri në një urdhër të dytë.
2. Përjashtim nga rregulli i caktuar në pikën 1 të këtij urdhri bëjnë mjetet e transportit të pajisura me autorizim të posaçëm nga autoritetet kompetente dhe mjetet e transportit të punonjësve në institucionet publike dhe/ose privatë të cilët lejohen të qarkullojnë në intervalin kohor 5:00 deri në orën 8:00 dhe midis intervalit kohor nga ora 16:00 deri 17:00.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit dhe Policisë Bashkiake.
4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË**  
**DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**Ogerta Manastirliu**